



Në bazë të nenit 33 të Statutit dhe nenit 4 të Rregullores së Punës të Këshillit Drejtues, Këshilli Drejtues merr këtë:

V E N D I M

- I. Themelohet **Qendra për Siguri Kibernetike - Cybersecurity Center** në kuadër të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike të Kolegjit AAB.
- II. Detyrat dhe përgjegjësitë, fushëveprimtaria, stafi i qendrës dhe çështje tjera më rendërsi për funksionimin e kësaj qendre do të parashihen me Rregulloren e Punës të Qendrës për siguri kibernetike e cila do të miratohet nga Këshilli Drejtues.
- III. Fakulteti i Shkencave Kompjuterike përgatit propozim rregulloren e punës për Qendrën për siguri kibernetike për miratim nga Këshilli Drejtues.
- IV. Zyra e PR kujdeset që qendra të ketë hapësirën e vet në kuadër të web faqes së Kolegjit AAB.
- V. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë.


A r s y e t i m

Qendra për Siguri Kibernetike themelohet në kuadër të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike, me qëllim të zhvillimit të kësaj fushe brenda fakultetit, marrjen dhe menaxhimin e granteve të kësaj fushe, kryerjen e aktiviteteve hulumtuese, ofrimin e shërbimeve profesionale, zgjerimin e rrjetit të bashkëpunëtorëve në këtë fushë, dhe të gjitha këto në funksion të ngritjes së kapaciteteve akademike dhe ngritjen e cilësisë së mësimdhënies në fushën e sigurisë kibernetike. Këshilli Drejtues duke vlerësuar rëndësinë e themelimit të një qendre të tillë, dhe pasi vlerësoj materialin e dorëzuar nga Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, vendosi si në dispozitiv të vendimit.

Vendimi iu dorëzohet:

1. Arkivit
2. Dekanit të FSHK
3. Zyres së PR




Prof.ass.dr. Lulzim Tafa
Kryetar i Këshillit Drejtues